



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT
DREJTORIA E OPERACIONALE

Nr. 24 / Prot.

Tirane 28.02.2011

URDHËR

Nr. 24 datë 28.02.2011

PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE NË STANDARDED
NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT DHE TË RAPORTIMIT
FINANCIAR, TË PËRKTHYER NË GJUHËN SHQIPE.

Në mbështetje të nenit 4, pika 3, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar, në vendimin nr. 1 datë 23.12.2010 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, “Për miratimin e Ndryshimeve të SNK dhe SNRF për vitin 2010” të cilat hyjnë në zbatim në vitin 2010 e në vazhdim, të përkthyer në gjuhën shqipe nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe pa u ndryshuar nga teksti origjinal në gjuhën angleze, sipas materialeve bashkëngjitur:

URDHËROJ

Shpalljen e ndryshimeve për përmirësimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Data efektive

- | | |
|---|----------------|
| 1. Ndryshime të SNRF 1 – Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve | 01 Janar 2011 |
| 2. Ndryshime në Shtojcën D të SNRF 1 | |
| 3. Ndryshime të SNRF 3 – Kombinimet e Bizneseve | 01 Korrik 2010 |
| 4. Shtojca për ndryshimet në SNRF 3 | |
| 5. Ndryshime të SNRF 7 – Instrumentat Financiarë (Dhënia e Informacioneve Shpjeguese) | 01 Korrik 2010 |
| 6. SNK 32 – Instrumentat Financiarë (Paraqitja) | 01 Korrik 2010 |
| 7. SNK 39 – Instrumentat Financiarë (Njohja dhe Matja) | 01 Korrik 2010 |
| 8. Ndryshime në SNK 1 – Paraqitja e Pasqyrave Financiare | 01 Janar 2011 |
| 9. SNK 21 – Efektet e ndryshimit në Kurset e Këmbimit të monedhave të huaja | 01 Korrik 2010 |
| 10. SNK 28 – Investimet në pjesëmarrje | 01 Korrik 2010 |
| 11. SNK 31 – Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta | 01 Korrik 2010 |
| 12. Ndryshime në SNK 34 – Raportimi Financiar i Ndërmjetëm | 01 Janar 2011 |
| 13. Ndryshime në KIRFN 13 – Programet e Besnikërisë ndaj Konsumatorëve | 01 Korrik 2010 |

Përrjashtim i kufizuar nga dhënia e informacioneve shpjeguese krahasuese sipas SNRF 7 për zbatuesit për herë të parë.

	Data efektive
1. Ndryshime të SNRF 1 – Zbatimi për herë të parë i SNRF	01 Korrik 2010
2. Ndryshime të SNRF 7 – Instrumentat Financiarë (Dhënia e Informacioneve Shpjeguese)	01 Janar 2009

Dhënia e informacioneve shpjeguese, transferimi i aktiveve financiare.

1. Ndryshime të SNRF 7 – Instrumentat financiarë (Dhënia e informacioneve shpjeguese)	01 Korrik 2011
2. Ndryshime të SNRF 1 – Zbatimi për herë të parë i SNRF	01 Korrik 2011

Ndryshimet e standardeve bëhen të detyrueshme për zbatim nga data efektive e kalimit e shprehur në Standard. Ato publikohen në fletoren zyrtare, faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe të Ministrisë së Financave

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të organizojë punën për botimin e ndryshimeve, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e lidhur për këtë qëllim, me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASCF) në Londër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Ridvan BODE

